



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr.118, datë 06.03.2024

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...}
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT, PËR POZICIONET E LIRA TË
SHPALLURA ME VENDIMET E KËSHILLIT NR. 236, NR.237, NR.238 DATË
24.05.2023 DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E
TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 06.03.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 236, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Me Vendimin nr. 237, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

3. Me Vendimin nr. 238, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

4. Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë për në Gjykatën Administrative të Apelit, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 25.05.2023, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 14.06.2023.

5. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Me Vendimin nr. 57, datë 07.02.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023”, Këshilli ka vendosur:

“1.Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë: 28.Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro.

7. Më datë 08.02.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Më datë 19.02.2024, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 11.03.2024, pranë ILDKPKI-së

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidaten për gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, znj. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedura e verifikimit është në proces e sipër.

12. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023 është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023 përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

13. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kritereve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

13.1 Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

13.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për

pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës administrative, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pas datës 12.10.2013 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, informacioni nuk iu kërkua gjykatave, ndërsa është e qartë përvoja e kandidatit në fushën e të drejtës administrative në Gjykatat Administrative (pra pas datës 12.10.2013 e në vijim).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

14. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

15. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën Administrative të Apelit, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*.

16. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit u mbajt parasysh se në këto gjykata gjykohen çështje me lëndë administrative, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, plotëson edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira, konkretisht në fushën e të drejtës administrative, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023.

17. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 07.07.1995. Kandidatja emërohet ndihmësgjyqtare efektive në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, në shkurt 1996. Më pas, në maj 1998 ajo është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ku ka ushtruar funksionin për periudhën 30.05.1998– 16.07.2013. Nga data 16.07.2013, ajo ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, si dhe nga periudha prill 2019-prill 2023 njëkohësisht ka ushtruar funksionin e zv/kryetares së Gjykatës. Me vendim e datës 25.05.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të riorganizuar”, nga data 01.07.2023 ajo transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.

18. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, *kandidatja ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 07.07.1995. Me vendim nr. 7, datë 08.02.1996 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtare efektive në Gjykatën e Rrethit Korçë. Me vendim nr. 15, datë 30.05.1998 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Korçë. Me dekret nr. 8266, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Me procesverbal të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë mbajtur më datë 17.04.2019 zgjidhet Zv/kryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, funksion të cilin e ka ushtruar deri më datë 17.04.2022 dhe në vijim ka ushtruar funksionin si gjyqtare pranë kësaj gjykate. Me procesverbal të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, mbajtur më datë 17.04.2023 zgjidhet Zv/kryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, funksion te cilin e ka ushtruar deri më datë 01.07.2023. Me vendim nr. 271, datë 25.05.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të riorganizuar”, nga data 01.07.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 28 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.*

19. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023, ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë, duke plotësuar kështu kriterin “përvojës profesionale minimale”.

20. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka eksperiencë të mjaftueshme në fushën e të drejtës administrative prej më shumë se 5 vjetësh.

21. Ndërkohë referuar të dhënave, rezulton se kandidatja z. {...}, nga data 16.07.2013 dhe në vijim, është gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe e më pas në Tiranë, e për rrjedhojë që nga kjo datë ajo gjykon vetëm çështje me lëndë administrative.

22. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës administrative, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

23. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

24. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*.

25. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 07.06.2023, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”*.

26. Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

27. Sa sipër, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet se për kandidaten znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

28. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

29. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

30. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 07.06.2023, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

31. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit.

32. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në Gjykatën Administrative të Apelit, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

33. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 571, datë 07.12.2021, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

34. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për s’kualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 236, datë 24.05.2023, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”; Vendimit nr. 237, datë 24.05.2023, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”; Vendimit nr. 238, datë 24.05.2023, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023 të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 236, nr.237, nr.238 datë 24.05.2023.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR